



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS DEÇAN

Numri i lëndës: 2021:014224

Datë: 06.03.2021

Numri i dokumentit: 01572062

**P.nr.32/2021**

### **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE PEJË DEGA DEÇAN** gjyqtari **Sultan Dobraj**, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Sabiha Hoxha, ne çështjen penale kundër të pandehurit Z. P. nga fshati .....K-....., për shkak te veprës penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par1. te KPK-së, duke vendosur lidhur me akuzën PP/II.nr.208/2021 të dt.28.01.2021, në shqyrtimin fillestar të mbajtur me dt.**25.02.2021**, me pjesëmarrjen e prokurorit te shtetit Arlinda Gacaferri dhe të pandehurit po të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me dt.**06.03.2021** përpiloi këtë:

### **A K T G J Y K I M**

**I pandehuri Z. P.**, i lindur me dt..... në fsh.....K-....., ku dhe tani banon rr....., i biri i A. dhe nënës N., me numër personal ....., tel....., shqiptar, shtetas i Kosovës, gjendet ne liri.

### **Ë S H T Ë F A J T O R**

#### **Për shkak se :**

Me dt.01.09.2019, rreth orës 13:00 në fsh. ....k-..... rr..... numër 7 përdor armë në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët me atë me nenin 41 dhe 42 në atë mënyrë që i pandehuri pasi njoftohet se është bërë gjysh e merrë një pistoletë BLOW TR34cal.9mm P.A.K. dhe me të shtënë në ajër disa herë kur bënë edhe, incizimin e tij për tu hetuar më pas nga policia e Kosovës.

**-Me çka ka kryer vepër përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par1. te KPK-së,**

Andaj gjykata, ne bazë te nenit 7, 17, 21, 38, 47, 48, 49, 69, nenit 367 par.1. të KPRK-ës, nenit 365, 453, të KPPRK-ës, të akuzuarin e:

## **G J Y K O N ME DËNIM ME KUSHT**

- I. I shqipton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej **1 (një) viti**, i cili dënim fare **nuk do të ekzekutohet** nëse në afat **prej 1 (një) viti** nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë, nuk kryen ndonjë vepër të re penale.
- II. Gjykata mund ta revokon dënimin me kusht nëse i dënuari gjatë kohës se verifikimit kryen një apo më shumë vepra penale.
- III. Konfiskohet pistoleta BLOW TR34cal.9mm me numër serik B04131720024, prodhim Çekoslovak te sekuestruara në bazë të listës së armëve të konfiskuara me numër rasti 2019 -DA-1944 të dt.27.09.2019.
- IV. I pandehuri lirohet nga shpenzimet e procedurës penale.

## **A r s y e t i m**

PTH ne Pejë me aktakuzën **PP/II. 2553/2019 të dt.29.12.2019** ka akuzuar Z. P. nga fshati .....K-Deçan, për shkak të veprës penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par1. të KPK-së, ka propozuar të caktohet shqyrtimi fillestar kundër të njëjtit, të administrohen provat e duhura e me në fund i njëjti të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit, si dhe të ngarkohet me shpenzimet e procedurës penale.

Gjykata themelore ne Pejë Dega ne Deçan me dt.18,03,2020 ka caktuar dhe ka mbajtur shqyrtimin fillestar ku pas leximit të aktakuzës i pandehuri e ka pranuar fajësinë, të cilin pranim fajësie gjykata e ka pranuar me aktvendim ne procesverbal te shqyrtimit gjyqësor në baze të nenin 248 KPPPK-ës.

Prokurori nga Prokuroria Themelore Pejë ka deklaruar se ky pranim fajësie mbështetet me provat materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës unë në tersi mbetem pranë aktakuzës dhe cilësimit juridik të saj gjykatës i propozoi që i njëjti të shpallet fajtor dhe ta dënon në bazë të ligjit, dhe rrethana lehtësuese të merr pranimin e fajësisë.

Av. G. D.ka deklaruar se pranimi i fajësisë është bërë në harmoni të plotë me ligjin, dhe i ka propozuar gjykatës që gjatë matjes dhe shqyrtimit të dënimit të merr parasysh rrethanat lehtësuese si: pranimin e fajësisë, ofendimin e thelle, premtimin se kurrë nuk do të kryer vepra të tilla penale, është i gjendjes së dobët ekonomike dhe nuk ka qenë i dënuar më parë.

I pandehuri në fjalën përfundimtare deklaroi se: shpreh keqardhje, jam shumë i penduar, premtoj se ne të ardhmen nuk do të përdor armë, kanë qenë moment gëzimi që me ka lindur nipi.

Gjykata me pranimin e fajësisë ne tërësi e ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

I pandehuri në kohë të pa njohur gjerë me dt.01.09.2019, rreth orës 13:00 në fsh. ....k-..... rr. .... numër 7 përdor armë në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët me atë me nenin 41 dhe 42 në atë mënyrë që i pandehuri pasi njoftohet se është bërë gjysh e merrë një pistoletë BLOW TR34cal.9mm P.A.K. dhe me të shtënë në ajër disa herë kur bënë edhe, incizimin e tij për tu hetuar më pas nga policia e Kosovës.

Këtë gjendje faktike gjykata e ka vërtetuar nga pranimi i fajësisë që ka bërë i pandehuri i cili i ka pasur te njohura natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, dhe në mënyrë vullnetare, me vetëdije, pa ndonjë detyrim, mashtrim apo lajthim e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barre, i cili pranimi fajësie mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit, dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore ose gabime faktike.

Po ashtu gjykata duke u kujdesur zyrtarisht në kuptim të nenit 257 të KPP-ës nuk ka gjetur ndonjë prove të pa pranueshme dhe gjithashtu është vërtetuar se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë konform nenit 248 të KPP-ës, ndërsa pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare, andaj kjo gjykate ka ardhur në përfundim se në veprimet e të pandehurit janë formuar të gjitha elementet e figurës së veprës penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.1. të KPK-së, ka konstatuar se i pandehuri ka qenë i vetëdijshëm për veprimet e ndërmarra, i ka dashur ato veprime, për veprimet e tilla të cilat përmbushen elementet e veprës penale të lartcekur është përgjegjës dhe i përgjegjshëm për veprën penale, andaj gjykata ka vendosur dhe të pandehurin e shpall fajtor për veprën penale, pastaj i ka shqiptuar dënimin e kushtëzuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata ka vlerësuar se dënimi i shqiptuar është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit, shkallën e rrezikshmërisë shoqërore, dhe në këtë mënyrë do të ndikoj në arritjen e qëllimit të dënimit që parashihet në nenin 38 të KPK-ës, si mase për parandalimin e të pandehurit por edhe si mase për parandalimin e të pandehurit dhe personave të tjerë kryes potencial të veprave penale nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Gjykata në bazë të nenit 47 lidhur me nenin 69 të KPK-ës, me rastin e vendosjes lidhur me lartësinë e dënimit gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, të cilat mund të ndikojnë në lartësinë dhe llojin e dënimit ndaj të pandehurve.

Rrethana lehtësuese gjykata ka gjetur se i pandehuri e ka pranuar fajësinë, pastaj kërkim falje nga ana e të pandehurit, pendimi i të pandehurit, premtimi i të pandehurit se në të ardhmen nuk do të përdor armë, sjelljen e mëparshme të pandehurit ku i pandehuri nuk është i njohur për gjykatën si kryes i ndonjë veprë tjetër, sjelljen të pandehurit pas kryerjes së veprës penale që nuk ekziston asnjë dyshim për ndonjë vepër tjetër penale kur edhe ka shprehur pendim të thellë dhe premtim se nuk do të përdor armë asnjëherë tjetër, rrethanat në të cilat është kryer vepra penale ku në rastin konkret im pandehuri e ka përdorur armën duke shtënë në ajër nga momente

gëzimi që i ka lindur nipi ndërsa si rrethanë renduese gjykata nuk e ka gjetur asnjë rrethanë.

Gjykata ne baze te nenit 367 paragraf 3 te KPK ka vendosur dhe e ka konfiskuar pistoleta BLOW TR34cal.9mm me numër serik B04131720024, prodhim Çekosllovak te sekuestruara në bazë të listës së armëve të konfiskuara me numër rasti 2019 -DA-1944 të dt.27.09.2019.

Gjykata në bazë të nenit 453 të KPPK-ës e ka liruar te pandehurin nga shpenzimet e procedurës penale sepse i pandehuri është i papunë, i gjendjes se varfër ekonomike, dhe po qe se do ngarkohet me shpenzime te procedurës penale do i rendohej edhe me shumë gjendja e varfër ekonomike..

Duke u bazuar ne te lartcekurat u vendos si ne dispozitiv.

**GJYKATA THEMELORE PEJË DEGA DEÇAN,  
P.nr.32/2021 të dt. 06.03.2021**

**Sekretarja juridike  
Sabiha Hoxha**

**G J Y Q T A R I  
Sulltan Dobraj**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimt të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet Gjykatës Themelore Peje dega në Deçan.